ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **NDËRMARRJA PUBLIKE BANESORE SH. A.**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP:

Nr. i Prokurimit[1]	**1909466981031194-24-1992-1-3-6**
Nr i brendshëm	**NPB 24 010 136**

Sa i përket tenderit për: **Furnizim me material zyrtar për nevojat e NPB-së**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

INFINITT SH.P.K
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr.28 Nentori, no.121
(Adresa)

Prishtinë — *10.000*
(Vendi) — *(Kodi postar)*

044/974-590 — */*
(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

Astrit Uka- menaxher
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë

Infinitt.shpk@gmail.com
(Adresa elektronike)

16.04.2024.
(Data e parashtrimit të ankesës)

REPUBLIKA E KOSOVËS INFINITT SH.P.K Prishtinë

(Nënshkrimi dhe vula)

[1] Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____/_____
(Emri i avokatit)

_____/_____
(Adresa e plotë)

_____/_____ _____/_____
(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____/_____
(Adresa elektronike)

_____/_____ _____/_____
(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për kontratë: 07.03.2024. Afati i fundit për dorzimin e ofertav: 12.03.2024. Data dhe ora e hapjes se ofertav: 12.03.2024. ora 13:30 Njoftimi mbi vendimin e AK: 05.04.2024. Kriter per dhenie te kontrates: Tenderi i pergjegjshem me cmimin me te ulet

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒ x

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [x] **Jo** [ ]

Letren standarde per tenderuesin e eleminuar se bashku me njoftimin mbi vendimin e AK i kemi pranuar ne e-prokurim me 05.04.2024.

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] **Jo** [ ]

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Kerkesen per ri-shqyrtim te AK kemi dorezuar me 08.04.2024.
Vendimi per pezullimin e aktivitetit te prokurimit 08.04.2024.
Vendimin per refuzim te kerkeses per ri-shqyrtim e kemi pranuar 12.04.2024.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1- Qellimi
Neni 6 - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
Neni 7- Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi
Neni 52- Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratës
Neni 59- Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
Neni 60- Kriteret për Dhënien e Kontratës
Neni 17 i RRPP- Dosja e tenderit

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Këto terme janë përdorur shumë herë në tekstin e mëposhtëm prandaj edhe i kemi përdorur shkurtesat që kanë domethënie si në vijim:
AK- Autoritet Kontraktues
OE- Operator Ekonomik
LPP- Ligji i prokurimit publik
UOPP- Udhezimi operativ per prokurim publik

AK/Komisioni vlersues gjatë vlerësimit të ofertave për aktivitetin e prokurimit në fjalë nuk ka vepruar në harmoni me LPP Nr. 04/L-042 I ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 perkatësisht dispozitat ligjore të lartëcekura dhe rregulloren per prokurim publik.
Me 05.04. kemi pranuar vendimin e AK-se.
Kompania jone eshte eliminuar duke u thirur ne nenin 17.11 te rregullore per prokurim publik me arsyetimin se kemi ofruar me shume se dy nr pas presjes dhjetore per 4 pozicione ne paramasen e tenderit.
Ky konstatim i AK nuk qendron, kompania jone ne kalkulimin e cmimit tek cmimi per njesi ka vendosur 2 nr pas presjes dhjetore. Tek pozicionet 4, 5, 6, 7 formula e kalkulimit ne excel ka shfaqur 3 zero pas presjes dhjetore tek totali me tvsh kur shumezohen sasite me njesi qe nuk paraqet problem ne kalkulimin e cmimit dhe cmimi total nuk ndryshon. Kuptohet qe eshte gabim teknik pasiqe vendosja e 3 nr pas presjes dhjetore tek cmimi per njesi do te interferonte tek totali dhe oferta jone do te bie ndesh me nenin 17.11 te Rrrpp. P.sh pozicioni 6 kemi ofruar cmimin per njesi 0.18 kur shumezohet me sasine 200 jep totalin 36.00 apo 36.000 qe eshte paraqitur ne kete rast ne excel, qe kuptohet se eshte gabim teknik gjate dorezimit te ofertes qe nuk perben problem dhe mund te cilesohet si devijim i vogel pasiqe totali i ofertes sone nuk ndryshon.
Sikur te ofronim p.sh cmimin per njesi 0.181 oferta do te konsiderohej e papergjegjshme, ne kete kuptim zbatohet dhe Rrregullorja per prokurim publik e cila ka hyre ne fuqi me 20.10.2022. te ciles i referohet autoriteti kontraktues zbatohet ne rastet kur OE ofron cmim me 3 nr pas presjes dhjetore, ne nuk kemi ofruar cmim per njesi me 3 nr pas presjes dhjetore prandaj arsyetimi i AK per elimimin e ofertes sone eshte jo-ligjor.
Autoriteti kontraktues nuk ka bere vleresimin e ofertav ne harmoni me nenin 59 te LPP-se, Citoj nenin 59.4 te LPP-se:

4. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, **autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspekin e tenderit ne fjalë**, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe

në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve. Ofertuesi nuk mund te eliminohet ne raste te tilla kur gabimet mund te korigjohen pa ndryshuar kushtin material e ne kete rast nuk ndryshon kushti material pasiqe 200x0.18= 36.00 apo 36.00000 nuk perben ndryshim ne totalin e ofertes. Nuk qendron konstatimi i AK ne letren standarde per eliminim dhe ne pergjigje te kerkeses per ri-shqyrtim se ne kemi ofruar me shume se dy numra pas presjes dhjetore, ne ofertim ne kemi vendosur cmimin per njesi me dy numra pas presjes dhjetore. Tek totali per njesi ne kater pozicione eshte vendosur shuma me tre numra pas presjes dhjetore perkatesisht zero qe nuk perben ndryshim ne totalin e ofertes dhe nuk kane ndikim ne llogaritje siq e sqaruam dhe me larte.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Si pasojë e shkeljeve të lartëcekura nga AK/ komisioni vlereses ka ardhe deri te dhenia e kontrates per OE me cmime me te larte se oferta jone, njekohesisht kompanise sone i eshte mohuar fitimi i nje kontrate publike si dhe fitimi simbolik i paramenduar nga kjo kontrate. Kërkojmë nga Organi shqyrtues i prokurimit qe pas shoshitjes se provave dhe fakteve te aprovoje ankesen e kompanise sone si te bazuar dhe lenda te kthehet ne ri-vleresim dhe te elaborohen edhe njehere ofertat duke mare parasysh faktin se totali per njesi i vendosur ne pozicionet 4, 5, 6, 7 me tre zero pas presjes dhjetore nuk ndryshon oferten dhe zbatimi i nenit 17.11 te rregullores per prokurim publik ne kete rast eshte i pa aplikueshem. Kërkojmë që ankesa të aprovohet si e bazuar.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
e) *bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
f) *Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe*
g) *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*